

**VENDIM**  
**Nr. 864, datë 29.12.2021**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 490, DATË 19.7.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “VLORA – ACU, RIKUALIFIKIMI URBAN NË QYTETIN E VLORES, PËRGJATË P4, C2, A, B, C” DHE “NDËRTIM I RRUGËS – VAZHDIM I UNAZËS VLORE – UJI I FTOHTË””, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, i ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në vendimin nr. 490, datë 19.7.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në pikën 3, shifra “... 165 224 816 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë milionë e dyqind e njëzet e katër mijë e tetëqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë ...” zëvendësohet me “... 176 168 174.40 (njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e katër pikë dyzet) lekë”.

b) Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 176 168 174.40 (njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e katër pikë dyzet) lekë, të përballohet, si më poshtë vijon:

- 165 224 816 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë milionë e dyqind e njëzet e katër mijë e tetëqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë, nga llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë;

- 10 943 358.40 (dhjetë milionë e nëntëqind e dyzet e tre mijë e treqind e pesëdhjetë e tetë pikë dyzet) lekë, nga buxheti i Bashkisë Vlorë.”.

c) Të dhënat për pasurinë me numër rendor 33, në tabelën e miratuar me vendimin nr.490, datë 19.7.2017, të Këshillit të Ministrave, zëvendësohen me të dhënat në tabelën “A”, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

d) Tabelës së miratuar me vendimin nr. 490, datë 19.7.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, i shtohet tabela “B”, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpenzimet procedurale shtesë, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

3. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Bashkia Vlorë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**

**LISTA E PRONARËVE TË PASURIVE PRONË PRIVATE QË PREKEN NGA DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 490, DATË 19.07.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “VLORA – ACU, RIKUALIFIKIMI URBAN NË QYTETIN E VLORËS, PËRGJATË P4, C2, A, B, C” DHE “NDËRTIM I RRUGËS – VAZHDIM I UNAZËS VLORË – UJI I FTOHTË”, TË NDRYSHUAR**

*Pasuri të shpronësuara nëpërmjet VKM-së nr. 490, datë 19.07.2017, të cilat pësojnë ndryshime*

*Tabela A*

| Nr .                        | Nr. rendor në VKM. Nr 490, datë 19.07.2017 | ZK   | ISHTE        |                    |                            |                            |                           |                | BËHET            |              |                            |                           |                            |                           |                          |                                                                                |
|-----------------------------|--------------------------------------------|------|--------------|--------------------|----------------------------|----------------------------|---------------------------|----------------|------------------|--------------|----------------------------|---------------------------|----------------------------|---------------------------|--------------------------|--------------------------------------------------------------------------------|
|                             |                                            |      | Nr. Pasurisë | Emër Atësi Mbiemër | Sipërfaqja e truallit (m2) | Sipërfaqja e objektit (m2) | Çmimi i objektit (lek/m2) | Vlera në total | Emër Mbiemër     | Nr. Pasurisë | Sipërfaqja e truallit (m2) | Çmimi i truallit (lek/m2) | Sipërfaqja e objektit (m2) | Çmimi i objektit (lek/m2) | Vlera objekt+truall lekë | Shënime                                                                        |
| 1                           | 33                                         | 8602 | 27/91-ND     | PPV                | 0                          | 38.2                       | 51,011.54                 | 1,948,641      | Merita Kapllanaj | 27/580       | 126.3                      | 10,903.00                 | 126                        | 51,012                    | 7,819,806                | Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë Truall + Ndërtesë. Objekti është në funksion banimi |
| Vlera totale për shpronësim |                                            |      |              |                    |                            |                            |                           | 1,948,641      |                  |              |                            |                           |                            |                           | 7,819,806                |                                                                                |

**Tabela B**

**Pasuri të cilat shtohen**

| Nr . | Emër Mbiemër | ZK | Nr. Pasurisë | Rrethi | Sipërfaqja e ndërtimit (m2) | Sipërfaqja e truallit (m2) | Çmimi i ndërtimit (lek/m2) | Çmimi i truallit (lek/m2) | Vlera e ndërtimit (lekë) | Vlera e truallit (lekë) | Vlera totale truall + ndërtesë (lekë) | Shënime |
|------|--------------|----|--------------|--------|-----------------------------|----------------------------|----------------------------|---------------------------|--------------------------|-------------------------|---------------------------------------|---------|
|------|--------------|----|--------------|--------|-----------------------------|----------------------------|----------------------------|---------------------------|--------------------------|-------------------------|---------------------------------------|---------|

[illegible]